

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS**, në mbështetje të nenit 9, paragrafët 1 dhe 2, 6 13 , nenit 75 dhe 78 paragrafi 2 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së, nr. 275, datë 30.12.2024, në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2026, miraton këtë:

Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Nr. 26 Datë 30/04/26

## VENDIM

**për miratimin e rregullave të sjelljes zgjedhore gjatë periudhës zgjedhore**

### I. Qëllimi

Me këtë vendim përcaktohen rregullat dhe standardet e sjelljes së kandidatëve, mbështetësve të tyre, votuesve dhe vëzhguesve gjatë periudhës së kandidimit, mbledhjes së nënshkrimeve mbështetëse, fushatës zgjedhore dhe ditës së votimit.

### II. Parimet e përgjithshme

1. Të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor janë të obliguar të respektojnë parimet e ligjshmërisë, barazisë, transparencës, paanshmërisë dhe integritetit të procesit zgjedhor.
2. Ndalohet çdo veprim që cenon lirinë e kandidimit, të votimit, fshehtësinë e votës apo rregullsinë e procesit zgjedhor.

### III. Ndalimet gjatë periudhës zgjedhore

Gjatë periudhës zgjedhore ndalohet:

1. Ushtrimi i presionit, ndikimit të padrejtë, kërcënimit apo kushtëzimit ndaj anëtarëve;
2. Sigurimi i nënshkrimeve mbështetëse përmes mashtrimit, detyrimit apo premtimeve të përfitimeve;
3. Pengimi i punës së KQZ-së dhe KNJZ-ve;
4. Qëndrimi pa autorizim në qendrën e votimit;
5. Ofrimi i shpërblimeve apo përfitimeve për sigurimin e votës ose mbështetjes;
6. Kërcënimi i kandidatëve, votuesve apo vëzhguesve;
7. Nxitja e personave pa të drejtë vote për të votuar;
8. Votimi më shumë se një herë apo votimi në emër të personit tjetër;
9. Përdorimi i gjuhës fyese, kërcënuese apo nxitëse të urrejtjes;
10. Ndërhyrja në votim, numërim apo administrim të materialit zgjedhor;
11. Çdo veprim tjetër që cenon rregullsinë ose rezultatin e procesit zgjedhor.

### IV. Sjellja e vëzhguesve

1. Vëzhguesit kanë të drejtë të përcjellin procesin zgjedhor sipas autorizimit të dhënë.
2. Vëzhguesve u ndalohet ndërhyrja në proces, ndikimi te votuesit apo pengimi i mbarëvajtjes së votimit.

## V. Paraqitja e ankesave

1. Çdo pretendim për shkelje të këtyre rregullave paraqitet në KQZ.
2. Ankesa paraqitet jo më vonë se 24 orë nga momenti i pretendimit për shkelje.
3. Ankesa duhet të përmbajë përshkrimin e shkeljes dhe dëshmitë përkatëse, kur ato ekzistojnë.

## VI. Masat ndaj shkelësve

Në rast të konstatimit të shkeljeve, KQZ-ja mund të ndërmarrë dhe incoj këto masa:

1. Masa etike dhe disiplinore;
2. Diskualifikimin e kandidatit nga procesi zgjedhor;
3. Inicimin e procedurave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

## VII. Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga KQZ-ja, më 30.04.2026.

### I dërgohet:

Anëtarëve të OFK-së;

Sekretariatit të KQZ-së.

**Kryetari i KQZ-së**

Mr.Ph. Betim Ramadani



Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komsioni Qendror i Zgjedhjeve

OFK - KQZ